



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIC OF KOSOVO
MUNICIPALITY OF SKENDERAJ
SKENDERAJ

Nr.
No. 01-060/01-0010147/25
Data.
Data 14.03.2025



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 43, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 37 paragrafi 1,3 të Statutit të Komunës së Skenderajt nr.01-110-385 të dt.03.12.2008, Rregulloren e punës së Kuvendit nenit 27, c në pajtim me rregullat e procedurës.

Ekstrat nga procesverbali i mbledhjes së **KOMITETI PËR POLITIK E FINANCAT**, i mbajtur me datë **20.02.2025**, në ora **10:00**, në sallën e bordit të drejtorëve.

Në këtë mbledhje janë diskutuar këto pika:

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
4. Informatë mbi shërbimet e dhëna nga QKMF, QMF dhe AMF, janar - dhjetor 2024,(raporton DSHMS, z. Shahin Tahiri);
5. Të ndryshme.

Kryesuesja e kuvendit znj. Adelina Spahiu: Të nderuar anëtar KPF-së, drejtor të drejtorive, në këtë mbledhje i kemi 5 anëtarë, bashkëngjitet mbledhjes Besiana Thaçi.

Vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës, e hap debatin, nëse nuk ka, konstatojmë me (5) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Rendi i ditës.

-Vazhdojmë me miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar, e hap debatin, nëse nuk ka konstatojmë me (5) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Vazhdojmë me piken 4 të rendit ditës:

-Informatë mbi shërbimet e dhëna nga QKMF, QMF dhe AMF, janar - dhjetor 2024,(Raporton); **Drejtori i DSHMS, Shahin Tahiri:** Fjala përshëndetëse, Kujdesi parësor shëndetësor ofrohet përmes QKMF-së, QMF-ve dhe AMF-ve, për rrethe 52,000 banorëve me një staf prej 184 punëtorëve. Kujdesi parësor shëndetësor në Skenderaj ka të zhvilluar rrjetin organizativ që përbehet nga 1 QKMF, 5 QMF, dhe 8 AMF. Në vitin 2024 e kemi pas numrin e lindjeve me të vogël me 30 lindje vaksinimi i fëmijëve dhe personave mbi 65 vjeç, është kryer në 90%. Raporti i të hyrave mjekësorë është në 18% me i madh së në vitin 2023. Kjo ishte në pika të shkurta sa i përket kësaj informata.

Kryesuesja: E hap debatin, nëse nuk ka, shkojmë në votim, konstatojmë me (3) vota për, (0) kundër dhe (2) abstenim rekomandohet për kuvend për përkrahje, Informatë mbi shërbimet e dhëna nga QKMF, QMF dhe AMF, janar - dhjetor 2024.

Vazhdojmë me piken 5 të rendit ditës;

-Të ndryshëm; e hap debatin nëse nuk ka, me kaq e mbyllim këtë mbledhje shihmi në seancë e kuvendit, për datë 27.02.2025, në ora 10:00, gjitha të mirat.

Procesmbajtësi

Kryesuesja e Kuvendit

